

PERTEF LIÇI

8JH-1

α 73

Lëndinat
e yjeve

poezi

8JH-1

L73

Pertef Liçi

LËNDINAT E YJEVE

Poezi



SHËNËJA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Redaktor
PERIKLI JORGONI

Piktore
SAFO MARKO

Reçensentë
Rudolf Marku,

Esnik Mustafaj

MOTËR, JETË

Në llërët e pjekura nga dielli i jugut,
Ka ca shifra të shkruara me fije kashte,
Janë përmasat e ditëve të punës,
Është atje toka, mbledhur e pjesëtuar.

Është vjersha e përditshme e drithit, e ujit,
Që kjo poeteshë e shkruan me dorën e njomë
Nëpër piskun e vapës së gushtit,
Nëpër cikmën e kaltër të dhjetorit.

Dhe për mua e merr malli shumë,
Ndaj sonte më ka dërguar një letër:
— Shpirt i motrës, pres akoma t'i lexoj
Ato vjersha që të mbushën gjithë jetën.

S'i t'i them unë asaj që e kam motër,
Gjithë këtë jetë që vazhdon me mirësi,
Dhe se brenda aq gjëra të bukura bashkon,
Sa t'i hedhësh në letër s'ke mundësi.

Ndaj, moj motër e dhimbsur, s'ke shpjegim.
Prej meje. Unë përgjigje s'do të kthej.
Nëse poezia ime nga koha ndahet një grimë,
Atëherë ti përgjigje të kërkossh patjetër.

PRISJA TË BËHESHA POET

Prisja të bëhesha poet
Që të shkruaja një këngë të bukur për ty,
Merrja penën, thosha erdhi ai çast,
Por befas, ti më ikje prej syve.

*Humbisje tutje, në rrugët me baltë,
Me një bluzë leshi e shami në kokë,
Degët e ullinjve i ngrinte si dallgë
Përballë teje era e dhjetorit.*

*Ti ngrohje gishtërinjtë me frymë,
Mblidhje kokrrat e ullinjve të rëna përdhe,
Të shkrinte në pëllëmbë argjendi i brymës.
Dhe mua do më kesh kujtuar atje.*

*Çoheshe pastaj, mendoheshe: — Ç'të pres?
Nxirrje rrënjë të kalbura dhe gurë,
Çlodheshe në këmbë, vije duart në mes,
Po përsëri, atje, do të jem kujtuar unë.*

*Eh! Unë prisja të bëhesha poet
Dhe të shkruaja pastaj një këngë të bukur,
Turp për mua që s'erdha në jetën tënde, vajzë,
Nder për ty që në këngën time s'u ktheve më
kurrë.*

SA MILIARDË ËSHTË BOTAI

*Ju thoni u bë bota 5 miliardë njerëz
Dhe u dashka ta besoj!*

*Po miliona maska,
Po miliona role,
Që futen midis?!*

*Po priftërinjtë dhe murgeshat,
Grevëthyesit dhe artistët surrealistë,
Burokratët dhe hipokritët
Dhe gjithfarë grykësish dhe vampirësh?!*

S'i pranoj kurrë në numrin e njerëzimit!

110 NGELET NJË ZOG 112

Tutje, kur shkoj arave të gjelbra,
Befas ndiej një brofëtimë prej tokës,
Rrahin krahët njëherësh e ngrihen në qiell
Tufa zogjsh.

Po pse më duket se dalin të gjithë
prej kraharorit tim?!

E ndërsa ngjitem lart e më lart,
Ndiej këtu midis brinjëve të mia,
Sikur më ka ngelur njëri...
në krahun e majtë...

Ai gjithmonë kërkon të fluturojë
E rreth flatrat.

SHIU

*Shiun vështroj nga dritarja
Si ma mbylli shtëpinë në këtë gropë të blertë,
U sul rrugëve, pyjeve, arave
E dalëngadalë nga sytë m'i fshehu.*

*Me një dritë të kaltër veshur nëna,
Pëshpërit te pragu: — O zot, ç'hata e madhe!
Qielli mbi tokë sikur ka rënë,
Telat elektrikë vishen me një push prej flake.*

*Fushës, bujqit s'e ndërpresin punën në këtë
tymësirë,
Të lagur gjer në palcë, baltrave e blerimeve,
Ndërsa burokrati mbyll perdet e zyrës,
Rrotullon çelësin në derë, fle gjumë në karrige.*

*Pemët mbi kafshimet e blerta të stuhisë,
Varin gjethet për të mjekuar lëkurën,
Vajzat e reja, me çizme përmes baltovinës,
Ia ndiejnë shijet në pikat sipër buzës.*

Dhe këtu nga kjo luginë e blertë,
Unë dal e çaj shtetrrëthimin e shiut,
Ndriçuar prej dritës së rrufeve,
Të besojë kjo grua plakë se perëndi është njeriu.

DËGJOJ ZEMRËN

Dëgjoj zemrën time sa çohem nga gjumi,
Kur troket në cipën e mëngjesit,
Mbase i kërkon atij yjet
që ia fshehu.

Kur dora jote e drojtur
Takohet me dorën time,
E dëgjoj zemrën.

E dëgjoj atë në ditët
Dhe e di mirë:
Mëngjesi fsheh yjet që mund të jenë botë
të vdekura
Dhe rizbulon njerinë.

GRAVE KOOPERATIVISTE

*Shkojnë nëpër llohërat e dimrit dhe vjeshtës,
Qëmtojnë ullinjte, mbjellin drithë a mollë,
Me duart e pastra si lëvorja e pemëve,
Që borën dhe vapën durojnë njëlloj.*

*Shkrin kalemi i artë i diellit
Mbi fytyrat e tyre në maj,
Si re dëbore mbi fushat e gjelbra
Shpështillet pëllëmbëve nitrati:*

*U shtrihet përpara toka e mbushur,
Me lastarët e blerimit e frutin e artë
Janë stolitë më të rralla rreth gushës
Që si duart e fëmijëve iu varen.*

*Nga zëri i tyre prej gruaje diçka ka toka,
Diçka ka juga e ngrohtë dhe thëllimi,
Në ditët e bukura të qyteteve tona
Arrin puna e tyre dhe mendimi.*

*Kështu ato ngjiten bregoreve dhe arave,
Veshur me të bardha e të kuqe,
Këto nëna të tokave-foshnja,
Të tokës nënë këto çupa të bukura.*

LËNDINAT E YJEVE

Netëve të vona më shfaqeshin para syve
Lëndinat e gjelbëra përtej fshatit;
Më dukej se nga qielli vareshin yjet,
Uleshin në lëndina së bashku.

Ikja fshehurazi nga shtrati
Mos të më ndjenin as motra, as nëna,
Kur i lodhur flinte gjithë fshati,
U afrohesha lëndinave në ëndrra.

Doja yjet t'i prekja pa u ndjerë,
Ç'ishte ajo dëshirë e paparë ashtu?!
Yjet sikur mendimet m'i kuptonin lehtë
Dhe ngrihesha në qiell tufë.

Unë çuditesha kur vinte mëngjesi,
Tej dritares, qielli i kaltër ishte bosh,
Nëna dhe motrat më kishin mbyllur derën,
Që pa gdhirë kishim mbërritur fushës poshtë.

Lëndinat janë bërë ara pjellore,
Unë atë ëndërr s'e pashë më, jam bërë burrë.
Ndoshta yjet me fluturime bardhullore,
Erdhën brenda meje e s'do largohen ndoshta
kurrë.

ÇAJUPI TEK NAIM FRASHËRI

*Unë e kam parë dhe Sheperin,
Dhe Frashërin e kam parë,
Ca vargmale në jug i lidhin,
Ca lugina në mes i ndajnë.*

*Po atje krillat venë dhe vijnë,
Dhe era vete e vjen si muzikë,
Thua janë vargjet e tyre në hapësirë,
Të argjendta si telat elektrikë.*

*Kaq afër ishin në vitet e fëmijërisë
Dhe dete të mëdhenj pastaj i ndanë,
Çajupi u nis prej Aleksandrisë,
Gjeti në Stamboll poetin e madh.*

*Dhe s'dihet ç'i thanë njëri-tjetrit,
(Pa dyshim kanë qarë me lotë)
Shqipëria nuk ishte atje.
T'ua fshinte sytë me dorë.*

Po ngelën tek njëri-tjetri,
Ngelën tek secili nga ne,
Asnjë mal nuk kanë midis,
Asnjë det me dallgë dhe re.

BIBLIOTEKA E RRËZIT
DURKASTËR
NR. 44576

PEMËT NË DIMËR

Pemët e plakura në dimër vuajnë,
Qajnë nën erë me ulërimë,
Lëshojnë një hije të padalluar mbi dhera dhe
ujëra.
Kafshët me shpinat qimengritur nga të ftohtit,
Nuk strehohen dot atje nga rrëmuja e shirave.

Të kërrusura rrinë në tokë radhë-radhë
E mua më kujtohen burrat, e gratë e vdekura
të fshatit,
Ata njerëz që dikur rininë e këtyre pemëve
të harlisura
E zbutën,
Në ar dhe mjaltë e kthyen nën këtë qiell
të kaltër.

Dhe në mes të këtij dimri më duket se kanë
dalë
Dhe qartë nuk u dallohet fytyra dhe trupi.
Në mbrëmje sikur fshihen poshtë në lugina
ngadalë,
Thuaj se erdhën për të përgjuar vazhdimin
e punës në tokë.

Unë shkoj duke u prekur lëkurën e çarë dhe
të ashpër
E më duket sikur prek duart e njerëzve të ikur
nga jeta,
Sikur fryma e tyre del nga të plasurit
e dheut
Dhe përmes rrënjëve të argjendta ngjitet nëpër
degë e fletë.

KUR PREVA FLOKËT E ZEZ

— motiv i vjetër popullor —

*Kur preva flokët e zez,
Ndjeva një rrëqethje të thellë.
Flokët nuk dhembnin kur priten,
Po unë qava, i dashuri im, atëherë.*

*M'u duk se preva gishtërinjtë e tu që
më ledhatonin.*

*Korba: ç'bëra kështu!!
Po thosha me vete,
Ndërsa flokët e zez barin mbulonin.*

*Do t'i ketë marrë uji të nesërmen,
Do t'i ketë pleksur nëpër rrënjët e dala
të bimëve,*

*Do t'i kenë marrë zogjtë në gojë
E do të kenë ndërtuar fole,
Era do të ketë lozur nëpër barishte, atje.*

*Ndërsa unë në një vajzë «tjetër» jam kthyer.
Do të vish ti nga ai vend i largët,
Nuk do më njohësh dot një çast,
Do të më kërkosh nëpër rrugët e fshatit.*

*Ndoshta për habinë dhe frikën,
Ndoshta për ndryshimin e fshehtë,
Qava,
Kur preva flokët e zez.*

RROBAT E NJERËZVE TË PUNËS

*Rrobat e lara mbi tela,
Mbi degët e pemëve në avlli
Të bardha, të kuqe, të gjelbërta
Si lule të ditëve të njeriut.*

*Mbrëmjeve i mbledhin nënat fshatare
Ngadalë se mos thyhen si qelqe.
Mos harrojmë, dikur trupi i tyre i mardhur
Humbiste nën katranin e ferecheve.*

*Pas tyre të rejat me gishtat e trëndafilta
Ndejnë të tjera, t'i terë flladi i natës.
Valviten ato nën hënë dhe yje
Parfumuar nga aroma e dheut dhe e barit.*

*Mëngjëset rrobat e lara mbi tela:
Mbështjellin shpatullat e punës,
Ditët me këto flatra të reja
Do enden brigjeve dhe fushave.*

ËSHTE NJË SHTËPI

Mos më kërkoni në stacionet e trenave
As në agjencitë e udhëtarëve,
Mos rri të presësh mes të panjohurve
Nga shikimet e tyre hutuar.

Është një shtëpi në një fshat të Jugut
Mbuluar nga ullinjtë dhe bajamet,
Janë atje pemët e mia të dashura dhe gurët,
Sa të shohin do të të thonë: mirë se erdhe!...

E më në fund te nëna ime po shkove,
Po ta tregoj, është në një kryqëzim
hekurudhash,
Atje do më ndjesh erën e rrobave,
Shqetësimet e mia tek malli i saj dhe tek
rrudhat.

Po mos u trishtoni nëse s'më gjen mua.
E dashur, dhe në s'jam atje ku jemi njohur,
Tek ajo shtëpi ku jam rritur më prit,
Se kurrë s'harroj të kthehem!

ANTARKTIDA

*Pesë cepa ylli,
Kontinenti planete ka gjashtë,
Brenda yllit gjaku,
Akulli, jashtë!*

PIKTURAT E DIELLIT

*Në dhomën time,
Mëngjes për mëngjes,
Në mure,
Me ngjyra floriri,
Dritaren pikturon dielli.*

*Pastaj brenda saj pikturon retë
si fjolla tymi,
Zogjtë dhe degët e pemëve,
Mali i madh lëviz aty,
Si anije prej letre.*

*Dhe e di mirë,
Kështu pikturohemi dhe unë e ti
Prej tij në tokë dhe në ajër.*

NJERËZ ME VEGLA NË KRAH

*Gjithmonë një vegël e mbajnë
E sa herë që e ngrenë nga dheu,
Duket sikur e kalitin tek dielli.*

Duarbosh, s'mbaj mend t'i kem parë ata njerëz,

*Toka rreth tyre është një kantier pa hekura
dhe dyer,*

*Ato, veglat, mbi supet e tyre të regjura
nga puna,*

Janë instrumentet e tyre.

*Nëse kompjuterat dhe superpajisjet me qarqe
integrale,*

Në kozmos e planete,

Zëvendësojnë forcën e krahut,

Veglat e tyre venë e futen në rrënjët

e bimësisë dhe tek poret e dheut

Ku fuqinë e merr lëvizja njerëzore dhe gjaku.

S'ËSHTE VONË

Ullinjtë jashtë uturijnë si' det,
Dritaret me perdet prej kristali të brymës
Janë veshur.

Nëna më thërret te dera,
Përgjigjem dhe brof,
Por prapë më duket
Se jam vonë.

Do të vij gjithnjë drejt teje,
O ditë, o jetë
Me prushin e këngës
Nëpër të rrahurat e zemrës!

Më e ɥmuar e më e shtrenjtë
Se gjithçka në gjithësi
Është mendimi dhe dashuria
Për ty,
Njeri!

SHPATEVE VAREN RRËKETË

*Shpateve varen rrëketë e verdka të barit,
Një gurgullimë e kuqërremtë zbret luginave,
Zetorët ngarkojnë togje misri të artë,
Ja, shirat e parë të vjeshtës po mbërrijnë.*

*E unë shkoj arave ku si me sitë të blertë
Gruri i ri tokën e ka mbushur,
Pse më duket se dheu në trup m'i ka veshur
Të gjitha ngjyrat e tij të bukura?*

*Pse vallë gëzoj si fëmijë
Dhe hapi në udhë më duket kaq i lehtë?
Mos vallë begatia e dheut në vjeshtë është
këngë*

E zemra më rreh si poet!

EDISONI DHE PERËNDITË

*Më në fund pas mijëra provash Edisoni
Në fillin e volframit gjeti burim drite,
Në Olimp, po të ekzistonin perënditë,
Vërejtje do t'i kishin hequr Zeusit
Pse kish shpifur për vdekjen e Prometeut
Ndër shkëmbinj.*

DJEPI

*Im atë të kish prerë në pyllin e fshatit
Duke kënduar një këngë trimash me vete,
Të kish gdhendur ty afër një zjarri.*

*Ti je anija e parë ku lundrova,
Ti je avioni i parë ku fluturova!*

*Lidhur me breza të kuq trupi im i vogël,
Qielli i mbuluar nga fytyra e nënës,
Mbytur zhurmat e shirave dhe erërave
Nga ninullat e motrave.*

*Se së pari,
Djepi im ka qenë fole e këngëve e zogjve
të malit,
Ka qenë tantella kristaline e shirave dhe borës,
Unë kam ardhur mbi shpatulla fshatari.*

Ajo gruaja që ka mbledhur bar erëmirë e lule
fushe
Dhe e ka vënë mbi kokën time,
Ka dashur që shpresat dhe ëndrrat e mia
të gjelbërta
Anëmbanë tokës të mbijnë.

STUHIA E MUNDUR

Gjithë natën e natës
Fshatarët dëgjonin përleshjen e stuhisë
me tokën.

Në mëngjes, sikur qielli të kish qenë
një pasqyrë gjigante,
Mbi fusha dhe rrugë që bërë copa-copa.

Pemët ishin shqyer,
Frutat e gjelbra qenë zhytur në baltë.
Fshatarët të kërrusur qëndronin herë pas here,
Pas tyre me lotë në sy ecnin gratë...

Gjithë ditën e ditës hapën kanale dhe prita
I ngritën vërshimit të saj të verdhë.
Brazdat me njëra-tjetrën u lidhën,
Nga avulli i tokës prapë qielli u bë i qelqtë.

VETËM NJË FJALË

*Vija të shtrembëra rërës Vjosa kish bërë,
Gjithë natën ish përpjekur,
Si ti që je përpjekur mbrëmë.*

*Vjosës kjo i ndodhi ngaqë shumë përrenj
të turbullt
Iu futën në trup me forcë,
Ty, vetëm nga një fjalë që ta thashë ashtu kot.*

*Aty nga mesdita era dhe dielli
I fshinë vijat e shtrembëra dhe lumi ngadalë
Kulloi dhe i kaltër u bë si më parë.*

*Ndërsa ti vazhdon mërinë me mua
Dhe rrugën dredhon...*

Vetëm një fjalë...

KAM DËGJUAR MALET E JUGUT NATËN

*Kam dëgjuar malet e jugut natën,
Oshëtijnë retë në shpellat dhe grykat
Apo Shemo Hajduti vazhdon të qëllojë mbi
koshadhet turke?!*

*Çairi kaltëron. Bari i argjendtë në flladin
e natës*

*Mos është vallë perçja e kujave të
Zenel Gjolekës apo të Rrapo Hekalit!?*

*Grumbujt e yjeve sipër kreshtave të tyre
Mos janë shkëndijëzat e kuqe të zjarrit
të Bilbilenjve?*

*Mjegulla poshtë luginave mos është vallë
Tymi i cigares që thithën para varjes?!*

*Hije janë ato që humbasin pas shkëmbinjve
më në juglindje,*

Apo vrasësit e Petro Nini Luarasit?!

*Vjosa gurgullon apo gjëmon mitralozi
i Asim Zenelit?!*

Mbi kurmin e tyre end hëna një pah të artë
E mua më duken sikur marrin frymë lehtë-
-lehtë.

Mos vallë kanë vuajtjen e lindjes së qymyrgurit
dhe të fosforit?

Malet e jugut i kam dëgjuar natën të tregojnë
Poemat e tyre të mrekullueshme,
Pastaj kridhen në një çlodhje të gjelbër
e të artë,

Kridhen në mallin e përjetshëm
Të Naim Frashërit.

DRURËT – FOSH NJE

*Nga pesha e madhe e viteve,
Kulmi i shtëpisë sime që bërë si hark.
Mora sëpatën në sup,
U futa në pyllin e madh.*

*Drurë të rinj ngriheshin përpyetë,
Rini e blertë me trup të njomë,
Kanë pritur tufanet në dimrin e egër,
Tani gumëzhinin prej bletëve dhe zogjve.*

*I prekja me dorë dhe ecja mes pyllit,
Këtë s'e pres dhe këtë tjetrin, jo!
Erdhi nata, nëpër ta po rridhnin yjet,
Unë i hutuar me vete seç thosha.*

*Dhe u gjenda në livadhin jashtë pylli.
Përsëri si erdha, me sëpatë në sup.
Drurët foshnje po nanurishnin nga era,
Në gjirin e pyllit po bënin gjumë.*

*Mendoja nënën, që më priste tek oborri
Me duart e kryqëzuara në gjoks.
Në trup unë pyllin s'e godita sonte,
M'u dhimbsën filizat e tij — foshnje.*

VERA ME SHIRAT E FUNDIT

*Dhe shiu heshti papritur,
Sikur s'duhej të binte, sikur kish bërë faj,
Pikat e tij të varura mbi gjethe e fruta
Si pika lotësh të bardhë.*

*Pastaj doli dielli me rrezet e tij,
I përshkoi tej e tej, i ndriçoi,
Në rrugicat e fshatit, mbi mundjen e shiut,
Hidrocentrale kashte fëmijët po ndërtojnë.*

*Unë shkel rrugët e zbutura në mbrëmje,
Nga vrima e dheut del aromë trëndafili,
Një mëz hirosh vrapon në arrishtë,
Kërkon nënën e vet që humbi gjatë shiut.*

*Bri stufës së sapondezur, var këmishën
e verdhë,*

*Nëna flokët m'i kreh me dorë,
Drapëri rri varur në mur si pikëpyetje,
Nesër të mbjellat e para fillojnë.*

*Ballin mbështes në kanatin e qullur të dritares,
Dëgjohen zëra midis pemëve, rrugëve,
kopshteve,
Janë zërat e verës që thotë se ikën e kënaqur.*

*E më mundon një frymëzim për shokët,
Për dashurinë e harlisjen e bimëve,
Që lëshohen drejt qiellit pas këtyre shirave.*

DETI

*10 ditë e 10 netë me radhë
Lundruam në det,
Pas më ndiqte si dallgë
Malli për ty, moj e shtrenjtë.*

*Në fund u kthyem në «spirancë»,¹⁾
Kapiteni dha urdhër: — Pushim!
Si mund të flija mbi det atë natë,
Kur ti më prisje me padurim?*

*E ndërsa bregut me rërë nxitoja,
Deti me zhaurimë vinte pas meje.
E dashura ime! — mendoja,
— Ku ta shpie detin?*

1) Spirancë — quhet qëndrimi i anijeve në det ose afër bregut pa lëvizur.

*Ti kishe dalë te rruga me plepa
E u puthëm me mall atë muzg,
Pranë nesh deti s'u ndje më, pushoi
Gjithë ajo zhurmë!*

*Ne pastaj na kishte rrëmbyer gjumi,
Në mëngjes bregut si ballë njeriu
Pamë detin të ngrinte dallgët,
Vetvetiu.*

*Sikur vraponin për të na kërkuar ne,
Sikur zgjateshin të na shihnin mbi xham,
Sikur na merrnin për dore tutje,
Deti ato i kishu - dërguar gjer larg.*

MËNGJESI NË MALE

Mëngjese prej guri dhe bari,
Gjysmë fëshfëritës, gjysmë të ngrirë,
Midis jush shkon njeriu me pallto në sup,
Duket sikur branë po tërheq diellin
Nëpër grykat e maleve futur.
E ai duke u përpyjekur midis shpateve e pyjeve,
Sikur merr zjarr...
Tremben tufat e pëllumbave dhe ajri i ngrirë
i natës,
Fillon e bën vija të argjendta mbi shpate,
Tani toka ngre një avull të bardhë,
Sikur merr frymë...
Ai, njeriu, ka varur xhaketën në një pemë
Dhe ka filluar punën.
Po, qenka ngritur me natë midis grykave
të maleve,
Për të sjellë diellin.

DHE TOKA SI NJË PEMË

*Dhe toka që është planet, e dashur,
Ka hijen e vet si një pemë grumbullore,
Ajo është nata ku ne flemë
Dhe me ëndrra të bukura zgjohemi.*

KY QYTET ME FRYMËN E NJERËZVE,
E DASHUR...

Këtë mëngjes dhjetori
Barin anës udhëve e ka thinjur bryma
E ky qytet fushor
Po zbulon trupin nga një çarçaf i bardhë.
Çudi, vetëm me këtë çarçaf të hollë
Paska fjetur gjithë natën e natës?!

Ti nuk më përgjigjesh fare.
Afroresh dhe, si për mbrojtje, puthemi,
Kur ndahemi shoh se si marrim frymë.
Një valë e bardhë ngrihet në ajër
Prej buzëve tona si flakëza të kuqe.

Ky qytet s'paska mardhur gjithë natën,
Se me frymën e njerëzve e ka ngrohur trupin
Dhe po me atë frymë në mëngjes shkriu
akullin.

VJERSHA E PYLLIT

*Atë vjershë e shkruan era dhe shiu,
Kafshët dhe shpezët,
Vetë dora e njeriut.*

*Vapa e verës mundohet ta thajë,
Bora e dimrit mundohet ta ngrijë.*

*Po unë
I shoh mirë rrënjët e lisave që shtrihen nën
dhé,*

*Myshkun e harresës
S'e lejoj, degët e shkozës e të kekëzës
T'i fshehë.*

*Urdhjen gjakpirëse me sëpatën time
S'e lë të gjarpërojë nëpër çerdhet e zogjve,
Se jam bir i këtij dheu e këngëtar si ti,
Që jetoj këtë mrekulli të jetës, të tokës.*

*Për vjershën tënde të përjetshme,
Pyll, të faleminderit!*

KAFSHËT E PUNËS

*Kafshët e punës dremisin e zgjohen natën
Me sytë si thëngjij nëpër errësi,
Shpinat ua rrënoqeth thëllimi,
Jashtë, në tokë gjurmët u kanë ngrirë.*

*Oh, t'i shihni kur shkon fshatari midis,
Tërë mirësjellje çohen, me frymën e ngrohtë
e veshin,
Të uruarat që dinë të përkulin shpinën,
Të pagojat, që me sy flasin gjithë jetën.*

*Dhe ai bar u hedh natën, u kruan qafën,
Sikur u pëshpërit në vesh me dhembshuri,
Unë tokën e punoj me lloj-lloj makinash,
Por shtegun hapur për tek puna ju do e keni
gjithnjë.*

TI NUK ERDHE ME MUA

*Treni u nis. Ti nuk erdhe,
Vështroj tani dy vijat e hekurta,
Që vijnë pas.
Dy vija paralele.*

*Hapësira ndryshon jashtë xhamave,
Pas fushave të pambukut vijnë fushat e grurit.
Brenda një kohe njerëz të ndryshëm
Jetojnë çaste të bukura.*

*Ndërsa tej, në skaj, në stacion
Të këtyre dy vijave paralele,
Ku një pritje fillon e tjetra mbaron,
Shpirtvogëlsia jote ka ngelur.*

*Ti nuk erdhe
E mua tani më kujtohet saktë
Teorema e Euklidit të lashtë.*

PEMËT

*Ato kanë nisur të vrapojnë
Që kur isha unë fëmijë.*

Kur të vdes unë, ato do ndalojnë.

*Pemët,
Lëvizja ime e pikturuar nëpër tokë.*

KUPÇELLAT E GURËVE

Edhe gurët e maleve
E kanë një vend të hapur që quhet kupçellë.
Pasi shkrin bora,
Pasi pushon shiu,
Ngelet uji i kulluar atje, me ngjyrë trëndafili.
Vete zogu dhe ngul sqepin,
Vete bleta dhe kafshët e malit,
Vete reja dhe sheh fytyrën e saj.
Edhe guri që është gur,
Në mikrosaharën e tij rikrijon jetën.
Ndërsa ti më thua:
— Në zemrën time asgjë s'qëndron...

S'do ta besoja

Edhe sikur gur të kishe në vend të saj.

ÇDO STINË

Çdo stinë më ka thirrur pylli i vendlindjes,
Po unë këtu s'kam qenë. Si t'ia bëj tani?!
Mora rrugën, më ndien shpendët dhe fluturuan,
Kafshët me të katra ia mbathën, u fshehën
Dhe unë mes pyllit i turpëruar kam ngelur.
Bari dhe drurët sikur më mbajnë mëri.

Po më thërrasin erërat e vjeshtës,
Ullinjtë muzgjeve duken si njerëz,
Muzgun me degët e fshijnë përreth...
Shkova atje. Ata duke uturuar
Me mua mbajnë mëri, janë zemëruar.

Bëj të fle, s'më zë gjumi. Pas xhamave
Hëna më derdh argjend mbi flokë.
Dal jashtë. Oh, jam i mrekulluar.
Por ajo, si grua nazemadhe, u fsheh
Pas drurëve, me mua pa folur.

Dal duke kopsitur këmishën
Muzgjeve të prillta të pranverës,
Unë që borërat e dimrit këtu nuk i pashë.
Flladet vrushkuj lulesh më kanë hedhur
Mbi trup si për inat.

Pylli-fushës, fusha-grunjërave,
Era-ullinjve e ullinjtë-muzgjeve,
Hëna-çative e yjeve, ujërave e luleve...
I kanë pëshpëritur njëri-tjetrit në vesh,
Sa herë që më kanë parë të vonohem,
Në trazimin e tyre të fshehtë.

NË VISET E MIA DËBORA...

*Në viset e mia dëbora është si ëndërr,
Bie gjithë natën
E ditën shkrin.*

*Vetëm një çast është akt habie
Dëbora,
Atje në viset e mia.*

*Unë s'kam arritur, kur isha i vogël,
Të bëja një njeri prej dëbore.
Sa mbaroja trupin dhe i vija sytë,
I shkriheshin këmbët, duart dhe koka
E copa-copa rrëzohej.*

*Në viset e mia dëbora është si ëndërr.
Atje njeriu ecën gjatë dimrit nëpër baltë
Dhe kodrave ua ngjesh mesin e gushën
Me rripa e gjerdane gurësh,
E pemëve u ngul furka, si duart e veta,
Mos t'i rrëzojë shiu e era.*

Që vargjet të mos më shkrijnë si njeriu
prej bore

E harroj verbimin e gjërave të kota
Dhe mrekullimin e tyre si ëndrra.

Vjersha ime i ngjan udhës së fshatarëve të mi
Nëpër baltën dhe shirat e dimrit,
Asaj balte që dielli e bën vlagë e pluhur
Dhe vera e mbush me jetën e bukur...

KTHIM

*Në faqen e një vagoni
Që tërhiqej për në jug,
Në lojë e sipër fëmijë të panjohur,
Emrin tënd kishin shkruar.*

*Unë, befas, qëndrova!
E ndërsa vazhdoja të udhëtoja për në veri,
Me mend më parë kisha mbërritur në jug,
Tek ti.*

DALLGËT

*E bëjnë bregun të bjerë në mendime,
Duke lënë sinusoidën e tyre përmbi rërë,
Kthehen prapë dhe pyesin: E ke zgjidhur?!
Dhe rrudhat nga balli ia fshijnë menjëherë.*

*Kështu vazhdon kjo pyetje e përjetshme,
Atje, tek vija, ku takohet deti me tokën,
Pyetje të tilla u bëjnë njerëzve ditët,
Po përgjigjen e vërtetë e jep vetë koha.*

VLORA

*Armiqtë duke ikur të mundur prej nesh.
Pas mjegullave të ishullit,
Mbanin frymën dhe lëshonin hakërrima të reja.*

*Populli të merrte në gjirin e këngës,
Plagët e kuqe
T'i shndërronte në lule.*

*Në breg të detit rri Vlora,
Sikur përgjon zhurmët thellë ujërave,
Tej deteve dhe kohërave,
E pamposhtur, monument qëndrese!*

ÇDO FUND GUSHTI

*Kam një mall të madh të shkoj
Arave të korrura të gushtit.*

*Ku paska vajtur vallë zhurmëria e ditëve
të verës.*

*Po mua pse më duket se këtu
Fjeta dhe u zgjova,
Dashurova dhe vuajta,
U rinova dhe u bëra burrë.*

*Po s'mund ta harroj,
Kur isha fëmijë dhe qaja me lotë,
Se katër stinët e vitit si në përralla,
Mblidheshin e luftonin me njerëzit.
Punën e gjithë vitit ua merrnin nga duart
Rrëmuja e shirave dhe erërave.*

*Pas makinave të drithit,
Nëpër tokën e përzhitur nga flaka e verës,
Vërej se asgjë s'paska mbetur sot
Nga hakërrimi i të katër stinëve,*

Paqë qenka nënshkruar kudo,
Që nga retë e zeza që mblidhen në qiell,
Që nga nxitimi i milingonave me fije kashte
në gojë,
Deri tek rendja e fshatarëve kryq e tërthor
tokës.

Po mua prapë si dikur mbi kokë,
Si qortim më zbret ajo fjalë e popullit:
«U nxi mëni, u nxi moti,
Mjerë ai që s'qe i zoti,
Që nuk mbolli e nuk korri!»

FRYMA E DETIT

*Natën, tek flija në një dhomë minatorësh,
Gjumi më doli befas,
Më kishte zgjuar frymëmarrja e shokëve
E në mendje më erdhi deti.*

P E R M B A J T J A

	Faqe
Motër jete	3
Prisja të bëhesha poet	5
Sa miliardë është bota	7
Ngelet një zog	8
Shiu	9
Dëgjoj zemrën	11
Grave kooperativiste	12
Lëndina e yjeve	14
Çajupi tek Naim Frashëri	16
Pemët me dimër	18
Kur preva flokët e zez	20
Rrobat e njerëzve të punës	22
Është një shtëpi	23
Antarktida	24
Pikturat e diellit	25
Njerëz me vegla në krah	26
S'është vonë	27
Shpateve varen rrëketë	28
Edisoni dhe perënditë	29

Djepi	30
Stuhia e mundur	32
Vetëm një fjalë	33
Kam dëgjuar malet e jugut natën	34
Drurët — foshnje	35
Vera me shirat e fundit	38
Deti	40
Mëngjesi me male	42
Dhe toka si një pemë	43
Ky qytet me frymën e njerëzve, e dashur	44
Vjersha e pyllit	45
Kafshët e punës	46
Ti nuk erdhe me mua	47
Pemët	48
Kupçellat e gurëve	49
Çdo stinë	50
Në viset e mia dëbora	52
Kthim	54
Dallgët	55
Vlora	56
Çdo fund gushti	57
Fryma e detit	59

Liçi, P.

Lëndinat e yjeve. Poezi.
[Red.: P. Jorgoni. Pikt.: S. Marko]
T., «Naim Frashëri», 1989

64 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891.983-1

L. 73

Tirazhi 1000 Formati. 70x100/32 Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re,

Tiranë, 1989

Liçi, P.

Lëndinat e yjeve. Poezi.

[Red.: P. Jorgoni. Pikt.: S. Marko]
T., «Naim Frashëri», 1989

64 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891.983-1

L. 73

Tirazhi 1000

Formati. 70x100/32

Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK

Shtypshkronja e Re,

Tiranë, 1989